



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 299/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dega në Partesh - Pasjane , paraqitur kundër subjektit politik G.I.Srpska ,dega na Partesh – Pasjane, për shkak të shqyerjes të posterave dhe Sloganeve të partisë SLS si dhe posterat e kandidatit për Kryetar Komune Nenad Cvetkoviç , në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Partesh – Pasjane.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 24.10.2013, nga subjekti politik SLS dega në Partesh-Pasjane , në të cilën theksohet se aktivistët e subjektit politik G.I Srpska në territorin e komunës së tyre rregullisht janë duke i shqyer dhe duke i mbuluar posterat dhe sloganet e partisë SLS dhe posterat e kandidatit për Kryetar Komune Nenad Cvetkoviç, dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim është shkelur , neni 3 pika a) të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe neni 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografitë nga tereni si dhe dy dëshmitarë të mundshëm.

PZAP-i, e informoi subjektin politik G.I. Srpska në kuptim të neni 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datën 25.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik G.I Srpska, në të cilën i mohojnë të gjitha akuzimet e supozuara si të pabazuara nga Shtabi Zgjedhor i Samostalna Liberalna Stranka në Partesh ,sepse paraqesin përpjekje për të diskredituar kundër – kandidati i G.I Srpska dhe që të akuzohet pa dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik G.I Srpska i kanë mbuluar posterat dhe sloganet e partisë SLS si dhe posterat e kandidatit për Kryetar Komune Nenad Cvetković, PZAP-i i vlerësoi të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë nuk mund të konsiderohet si e bazuar, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 299/2013 më datën 25.10.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*